



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 207-18-8348-4-3-2

Sa i përket tenderit për **HARTIMI I PROJEKTIT IDEOR DHE PROJEKTIT ZBATUES PËR QENDRËN KULTURORE NË PAGARUSHË TË MALISHEVËS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PRIMA INVEST Sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kodra e Diellit, Rr.3, L..20, nr.8
(Adresa)
Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044 110 638; 049 145 820
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Arianit Bytyçi, arkitekt
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

arianit.bytyci@gmail.com; primainvest.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

2 Dhjetor 2019
(Data e parashtrimit të ankesës)

SH.P.K.
PRIMA INVEST
Prishtinë
(Nënshkrimi dhe datimi)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi për konkursin e projektimit: 29.10.2018
- Sqarimi pas pyetjeve të OE-ve: 15.11.2018
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kandidatit dhe koncept projekteve: 26.11.2018
- Njoftimi për hapje financiare: 4.02.2019
- Njoftimi për vendimin e AK-së: 14.02.2019
- Vendimi në kërkesën për rishqyrtim: 21.02.2018
- Njoftimi i AK-së pas procesit të rivlerësimit: 19.06.2019
- Njoftim për pezullim: 05.07.2019
- Njoftim për vendimin e AK-së: 26.08.2019
- Vendimi i OSHP-së: 23.10.2019
- Njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues: 21.11.2019
- Kërkesa për rishqyrtim: 26.11.2019
- Përgjigje (vendim) në Kërkesën për rishqyrtim: 29.11.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input checked="" type="checkbox"/>			Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	----	--------------------------

Është bërë hapja e ofertave financiare

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po	<input checked="" type="checkbox"/>			Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	----	--------------------------

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	<input checked="" type="checkbox"/>			Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	----	--------------------------

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Si OE pjesëmarrës në këtë konkurs projektimi, kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së, dhe AK ka marrë vendim për refuzim të kërkesës sonë;
(Bashkëngjitur me këtë ankesë e keni kërkesën për rishqyrtim bashkë me vendimin përkatës të AK-së)

Përgjigja e AK-se në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 1-rë të vendimit të OSHP-së

AK në asnjë pjesë të vendimit të saj (*Raportit të rivlerësimit dhe përgjigjes në kërkesën tonë për rishqyrtim*) nuk merret me vërtetimin me saktësi të pretendimit tonë ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nje projekt të lagjes së shtëpive e ka prezentuar rrejshëm si plan rregullues. Është me rëndësi të potencohet fakti se vërtetimi me saktësi i këtij pretendimi tonë ankimor ka qenë i lehtë të bëhet, për arsye se AK-ja ka pasur qasje në listën e kontratave dhe referencave të këtij OE ku është prezentuar rrejshëm si plan rregullues projekti i lagjes së shtëpive, duke shkelur kështu nenin 415 - *Keqpërdorimi dhe mashtrimi ne prokurim publik* të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, lidhur me kërkesën e OSHP-së ku kërkohet të vërtetohet se a është hartuar Plan Rregullues (*ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontrates dhe referencës*), AK-ja as në Raportin e Rivlerësimit, e as në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim **nuk përgjigjet drejtpërdrejtë dhe me saktësi konform kërkesës së OSHP-së e cila pyet qartë: a është hartuar plan rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontrates dhe referencës).** AK-ja lidhur me këtë kërkesë të OSHP-së bën shmagje totale nga përgjigja me saktësi në këtë kërkesë dhe pa ndonjë argument të saktë ligjor konstaton se "*kontrata dhe referenca është EKVIVALENT me kërkesën e dosjes së tenderit dhe me rekomandimet e OSHP-së*".

Pra, në këtë rast shihet qartë se AK nuk konstaton se është hartuar plan rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës), por pa argumente të bazuara ligjërisht thotë që kontrata dhe referenca është ekuivalente me kërkesën e dosjes së tenderit dhe me rekomandimet e OSHP-së, gjë që nuk ka qenë as kërkesë e Dosjes së Konkursit të Projektimit, e as kërkesë e vendimit të OSHP-së të konstatohet ndonje lloj e ekuivalencës apo e ngjashmërisë. Në Dosjen e konkursit të projektimit **kërkohen saktësisht kontrata dhe referenca për PLANE RREGULLUESE** e jo ekuivalente apo të ngjashme me plane rregulluese. Po ashtu në vendimin nt.595/19 të OSHP-së **kërkohet të saktësohet se a është hartuar Plan Rregullues** (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës) e jo ekuivalent apo i ngjashëm me plane rregulluese, por është kërkuar saktësisht kontrata dhe referenca për plane rregulluese.

Është me rëndësi të theksohet se edhe nëse kërkesa e AK-së në Dosjen e Konkursit të Projektimit të ishte "kontrata dhe referenca për Plane rregulluese apo të ngjashme (ekuivalente)" kjo kërkesë nuk do të mund të përmbushej nga OE GM Architecture për arsye se **ZGJIDHJA URBANE sipas bazës ligjore në fuqi dhe sipas interpretimit të MMPH-së (datë 13.09.2019) nuk është kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor, pra nuk është ekuivalente apo e ngjashme me Planin Rregullues.**

Si konstatim mund të thuhet se AK gjatë rivlerësimit nuk ka arritur të dëshmojë se OE i rekomanduar për kontratë ka hartuar Plan Rregullues. Me këtë rast, konstatohet qartë se nuk janë plotësuar Kërkesat mbi mundësitë tenike/profesionale të kërkuar nga AK në Dosjen e Konkursit të Projektimit dhe nuk është respektuar vendimi nr.595/19 i datës 23.10.2019 i OSHP-së.

2. Kërkesa e 2-të e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

AK duhet që konform nenit 72 të LPP-së të vërtetojë 2 dëshmitë e ofruara nga OE ankues: dëshminë e parë: sa i përket vendimit 05 nr.350-271083 i datës 25.01.2017 i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për caktimin e Kushteve Ndërtimore; si dhe dëshminë e dytë lidhur me vendimin 05 nr.351/02-0247279/17 të datës 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për Lejimin e Ndërtimit. Paneli Shqyrtues konstaton se **AK duhet të vërtetojë se përmes këtyre 2 vendimeve a është hartuar Plan Rregullues apo është hartuar zgjidhje urbane e projekteve të shtëpive individuale.**

Përgjigja e AK-se në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 2-të të vendimit të OSHP-së

AK-ja thotë që bazuar në vendimin e OSHP-së nr.595/19 të datës 23.10.2019 dhe konform nenit 72 të LPP-së i është drejtuar OE GM Architecture për sqarime shtesë dhe ka marrë përgjigje në këto sqarime shtesë. AK thotë që sqarimet janë konform pyetjeve të parashtruara.

Është me rëndësi të potencohet se OE GM Architecture në përgjigjet e veta askund nuk ka arritur të konstatojë se në baze të 2 vendimeve të Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është hartuar Plan Rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës). Argumentet tona tjera të detajuara që kontestojnë ligjërisht përgjigjen e OE të rekomanduar për kontratë i kemi prezentuar në Kërkesën për Rishqyrtim (që është bashkëngjitur kësaj Ankese).

Më tej, në Raportin e vlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim **AK-ja duke mos dhënë përgjigje në kërkesën e OSHP-së lidhur me 2 dëshmitë e vendimeve të Komunes së Prishtinës** thotë: *"...shihet qartë që ZGJIDHJA URBANE e cila theksohet në këtë rast përmban TË GJITHA kërkesat, detaje apo kushtet të cilat aplikohen edhe në rastet e hartimit të një Plani Rregullues të Hollësishëm për një zonë të caktuar. E për të cilën ne kemi konsideruar dhe konsiderojmë se dallimi në këtë rast ka të bëjë thjeshtë me natyrën administrative të emërimit të dokumentit i cili në rastin kur quhet Plan Rregullues i Hollësishëm duhet të jetë dokument i aprovuar nga instancat e pushtetit lokal. Ndërsa, në rastin e dytë ai emërtohet duke u bazuar në kriteret profesionale, pra pa ndonjë dallim tjetër. Megjithatë, një ZGJIDHJE URBANE e përmasave të tilla për një zonë mbi 14 ha, që është ofruar nga pala plotëson kriteret e eksperiencës së dokumentuar, sepse kjo zgjidhje përmban përcaktimin e elementeve urbane me shumë planifikimit urbane, në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal".*

Pra, siç dëshmohet edhe nga Raporti i Rivlerësimit i AK-së, po ashtu edhe nga Përgjigja e AK-së në kërkesën tonë për rishqyrtim, AK duke mos potenciuar askund 2 vendimet e Komunës së Prishtinës për këtë projekt të lagjes së shtëpive individuale, **AK vetë konform kërkesës së vendimit nr.595/19 të datës 23.10.2019 të OSHP-së vërteton se është hartuar ZGJIDHJE URBANE e JO PLAN RREGULLUES (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja që hartimi i planit rregullues të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës).** Se është hartuar zgjidhje urbane është e dëshmuar edhe në vendimin 05 nr.350-271083 të datës 25.01.2017 i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për caktimin e Kushteve Ndërtimore, **ku teksualisht shkruan që është hartuar ZGJIDHJE URBANE.**

Ndërsa, se a është i njëjtë Plani Rregullues me Zgjidhjen Urbane është vërtetuar me saktësi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në interpretimin e saj (datë 13.09.2019) ku konstatohet se Plani Rregullues është kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor, ndërsa Zgjidhja Urbane dhe Projekti Urbanistik NUK JANË (nuk ekzistojnë) si kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Pra, bazuar në këto argumente ligjore dëshmohej se AK-ja gjatë procedurës së rivlerësimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Dosjes së Konkursit të Projektimit, të LPP-së dhe RrUOPP-së dhe vendimin nr.595/19 të datës 23.10.2019 të OSHP-së për arsye se:

- edhe pse ka konstatuar se është hartuar ZGJIDHJE URBANE e jo Plan Rregullues, është munduar ta tejkalojë dhe madje edhe ta ndryshojë kërkesën e Dosjes së Konkursit të Projektimit për kontrata dhe referenca për plane rregulluese të hartuara, duke dhënë konstatime të pabazuara për përmbushjen e kësaj kërkesë të Dosjes së Konkursit të Projektimit dhe në të njëjtën kohë duke u munduar që të modifikojë kërkesat e Dosjes së Konkursit të Projektimit duke thënë se ZGJIDHJA URBANE është ekuivalente me PLANET RREGULLUESE (edhe ngashmëria apo ekuivalenca me plane rregulluese nuk ekziston si kërkesë as në Dosjen e Konkursit të Projektimit e as në kërkesat e vendimit nr.595/19 të datës 23.10.2019 të OSHP-së);

- vendimin e vet për rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit AK e bazon në interpretime të lira të komisionit të rivlerësimit, interpretime këto të mbështetura vetëm në pohimet jokompetente dhe jo të bazuara ligjërisht të subjektit të kësaj çështjeje kontestuese – OE të rekomanduar për kontratë;

- AK sipas nenit 72 për sqarime shtesë lidhur me kërkesën e OSHP-së për vërtetimin me saktësi të 2 dëshmimeve, përkatësisht 2 vendimeve të Komunës së Prishtinës (vendimit 05 nr.350-271083 të datës 25.01.2017 i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për caktimin e Kushteve Ndërtimore; si dhe dëshminë e dytë lidhur me vendimin 05 nr.351/02-0247279/17 të datës 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për Lejimin e Ndërtimit) se a është hartuar plan rregullues, ka qenë e obliguar që këtë vërtetim të fakteve ta bëjë duke u bazuar në këto 2 vendime dhe nëse e ka vlerësuar të nevojshme të marrë sqarime shtesë zyrtare nga vetë Komuna e Prishtinës për kërkesën e OSHP-së se përmes 2 vendimeve të Komunës së Prishtinës a është hartuar plan rregullues apo jo (edhe pse kjo gjë është e qartë vetëm po të lexohen këto 2 vendime të Komunës së Prishtinës dhe po ashtu kjo qartësohet edhe më shumë nga konfirmimi i Komunës së Prishtinës i datës 30 gusht 2019 ku konfirmohet se “Komuna e Prishtinës nuk ka asnjë Plan Rregullues të miratuar me emrin “Hasan Prishtina” në Çagllavicë. Të gjitha planet rregulluese dhe zhvillimore janë të publikuara në ueb faqen e Komunës” (dëshmi kjo bashkëngjitur kësaj ankese); Me këto veprime, duke tentuar të tejkalojë, modifikojë e të interpretojë pa bazë ligjore kërkesat e Dosjes së Konkursit të Projektimit, ku kërkohen kontrata dhe referenca për plane rregulluese të hartuara, AK ka shkelur nenin 41 të RrUOPP-se ku thuhet: “Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së përfshirë një urdhër për ri-vlerësim”.

3. Kërkesa e 3-të e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

AK duhet të konstatojë se Projekti i emërtuar si Zgjidhje Urbane apo si Projekti Urbanistik dhe Infrastruktura e Lagjes (ashtu siç është projekti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë) a ekzistojnë si kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Përgjigja e AK-se në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 3-të të vendimit të OSHP-së

As AK, por as OE i rekomanduar për kontratë në asnjë rast nuk japin përgjigje në kërkesën e lartpërmendur të OSHP-se të prezantuar përmes vendimit nr.595/19 të datës 23.10.2019.

AK e ka pasur shumë të lehtë të përgjigjet në kërkesën e vendimit të OSHP-së për arsye se e ka pasur në dispozicion interpretimin e MMPH-së (datë 13.09.2019, bashkëgjitur kësaj anekse) ku thuhet qartësisht se **Zgjidhja Urbane dhe Projekti Urbanistiki lagjes NUK EKZISTOJNË si kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor.**

4. Kërkesa e 4-të e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

Paneli shqyrtues i OSHP-së konstaton se gjatë rivlerësimit AK-ja duhet të ketë parasysh nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së i cili thotë: "Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me TË GJITHA kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"

Arsyetimet e AK-se të prezentuara në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 4-të të vendimit të OSHP-së

AK me arsyetimin e saj në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen e kërkesës sonë për rishqyrtim dëshmon se gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka respektuar nenin 59 paragrafin 4 të LPP-së për arsye se e ka konsideruar një OE të përgjegjshëm, edhe pse dokumentacioni i këtij operatori ekonomik NUK ISHTE në përputhshmëri me TË GJITHA kërkesat e parashtruara në njoftimin e konkursit të projektimit dhe në dosjen e konkursit të projektimit.

Nga argumentet e mësipërme të prezentuara në këtë ankesë dhe në kërkesën tonë për rishqyrtim, dëshmohet qartësisht se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Konkursit të Projektimit, e prezantuar tek pika 9.1 dhe 9.2 e Fletës së të dhënave të tenderit (FDT) tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku kërkohet që: *"Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar kontrata në lëmin e hartimit të projekteve të investimeve publike apo/dhe investimeve private, si dhe PLANEVE RREGULLUESE në vlerë 40,000.00 €"*. Dhe, për të dëshmuar këtë kontratë si dëshmi e kërkuar dokumentare kërkohet që *"të paraqiten dëshmitë: referenca për projekte*

dhe PLANE RREGULLUESE të hartuara në vlerën 40,000.00 euro (katërdhjetë mijë euro)”

Bazuar ne argumentet e lartpërmendura të cilat dëshmojnë se OE i rekomanduar për kontratë është OE i papërgjegjshëm ligjërisht, **kërkojme nga OSHP që bazuar në kompetencat e saj ligjore përmes një URDHËRESE të detyrojë ligjërisht AK-në që duke e kthyer në rivlerësim këtë aktivitet prokurimi të shpallë fituesin e këtij aktiviteti prokurimi nga renditja e OE-ve të përgjegjshëm.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
- e) DËSHMIA NR.1 - Vendimi 05 nr.350-271083 i datës 25.01.2017
- f) DËSHMIA NR.2 - Vendimi 05 nr.351/02-0247279/17 të datës 06.05.2019
- g) DËSHMIA NR.3 – Konfirmimi i vetë GM Architecture përmes uebfaqes zyrtare ku dëshmohet që ka hartuar ZGJIDHJE URBANISTIKE e JO PLAN RREGULLUES
- h) DËSHMIA NR.4 – Emaili drejtuar Komunës së Prishtinës dhe përgjigja e Komunës që dëshmon se NUK EKZISTON ASNJË PLAN RREGULLUES ME EMRIN PLANI RREGULLUES I LAGJES “HASAN PRISHTINA” ÇAGLLAVICË
- i) Një kopje e Raportit të rivlerësimit
- j) një kopje e Kërkesës për rishqyrtim, dërguar AK-së, në përputhje me nenin 108/A të LPP-së
- k) një kopje e Vendimit të AK-së lidhur me Kërkesën për rishqyrtim

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.